

VENDIM
Nr. 164, datë 15.5.2023

**MBI PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS TË IMPIANTIT
FOTOVOLTAIK TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË DIGËN E
QYRSAQIT, HEC “VAU I DEJËS”, TË SHOQËRISË “KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE” (KESH) SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 7 dhe 8, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 991/6 prot., datë 11.5.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s, “Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrfaqit, HEC ‘Vau i Dejës’, të shoqërisë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 75, datë 15.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrfaqit, HEC “Vau i Dejës”, të shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) sh.a., për periudhën 13.5.2022–31.12.2022.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 991/2 prot., datë 23.3.2023, duke i evidentuar dhe dokumentacionin që mbetej ende për t’u plotësuar.

- Në përgjigje, shoqëria ka përcjellë dokumentacion me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 991/5 prot., datë 5.4.2023.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 21.7.2022, është vendosur kualifikimi i këtij impianti fotovoltaik, ndërkohë që rezulton se ky është aplikimi i parë i shoqërisë KESH sh.a., për pajisje me certifikatë të garancisë së origjinës për këtë impiant, i cili sikurse ka rezultuar dhe nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës së kualifikimit të impiantit, është energjizuar më datë 13.5.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 991/4 prot., datë 30.3.2023, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. ka paraqitur informacion në formë tabelore për sasinë e energjisë elektrike të injektuar në rrjetin e transmetimit, të ndarë sipas muajve dhe totalin për vitin 2022, nga ku rezulton se sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në rrjet nga impianti fotovoltaik në digën e Qyrfaqit, HEC “Vau i Dejës”, për periudhën 13.5.2022–31.12.2022 është 4,203 mwh.

- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria KESH sh.a. rezulton i plotësuar, si më poshtë:

- aneksi 1, formati i aplikimit, germat: “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar;
- neni 7, pika 7.4, kërkesa për lëshimin e garancisë së origjinës, germat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”. Plotësuar;
- neni 7, pika 7.5, dokumentacioni teknik, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Në zbatim të nenit 14.1 të rregullores, garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 12-mujore dhe shteron fuqinë e saj, me përfundimin e këtij afati, të shprehur edhe në certifikatën e lëshuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pajisë me certifikatë të garancisë së origjinës impiantin fotovoltaiik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, të shoqërisë “Korporata Elektroenergetike Shqiptare” (KESH) sh.a., për periudhën 13.5.2022–31.12.2022, për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 4,203 mwh.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti